

VENDIM
Nr.893, datë 22.12.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.11.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në paragrafin e parë të pikës 7, pas fjalës “...punonjësve...” shtohen “...të institucioneve buxhetore...”.

b) Lidhja II “Paga bazë sipas klasave”, Lidhja II/1 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e shëndetësisë” dhe Lidhja II/M “Paga bazë për punonjësit e ministrive, të institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, zëvendësohen me lidhjet, me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

c) Në klasifikimin B5 të Lidhjes I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, shtohen këto emërtesa:

“Zëvendësudrejtor në Bibliotekën Kombëtare”,

“Zëvendësudrejtor në Institutin e Monumenteve të Kulturës”.

ç) Lidhja II-18 “Niveli i pagave për punonjësit e këshillave të rretheve e bashkive”, zëvendësohet me Lidhjen II-18 “Niveli i pagave për punonjësit e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i shkronjave “b” e “c” të pikës 1 të këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit për paga e sigurime shoqërore, për institucionet buxhetore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe për punonjësit që përfitojnë rritje page, sipas shkronjës “b” të këtij vendimi, efektet financiare fillojnë nga data 1 korrik 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2	II	11000
3	III	11300
4	IV	11600
5	V	11900
6	VI	12400
7	VII	12800
8	VIII	13300
9	IX	13800
10	X	14000
11	XI	14500
12	XII	15500
13	XIII	18500
14	XIV	23000

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT E SHENDETESISE

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2	II	11000
3	III	11300
4	IV	11600
5	V	11900
6	VI	12000
7	VII	12500
8	VIII	12900
9	IX	13500
10	X	14000
11	XI	14500
12	XII	16000
13	XIII	19000
14	XIV	23000

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT E MINISTRIVE,
INSTITUCIONEVE TE TJERA QENDRORE, ATSH, PREFEKTURAVE DHE
SHERBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2	II	11300
3	III	11800
4	IV	12400
5	V	13500
6	VI	14500
7	VII	16500
8	VIII	19000
9	IX	21000
10	X	25500

**NIVELI I PAGES PER PUNONJESIT E DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE
SHERBIMIT TE PERMBARIMIT GJYQESOR**

I.

Nr.	EMERTIMI	KLASIFIKIMI
1.	Drejtor i pergjithshem.	A12
2.	Zevendesdrejtor i pergjithshem.	B3
3.	Pergjegjes i sektorit te inspektimit.	B5
4.	Inspektor i permbarimit gjyqesor.	B5
5.	Kryetar i zyres se Permbarimit.	B5
6.	Permbarues. Psikolog.	C2

II.

Nr.	EMERTIMI	KLASA	SHTESE PER FUNKSION
1.	Pergjegjes sektori ne drejtorine e pergjithshme.	IX	5
2.	Pergjegjes sektori ne zyrat permbarimore.	IX	3
3.	Specialist ne drejtorine e pergjithshme e ne zyrat permbarimore.	VIII	

Shenim: Per punonjesit e tjere, zbatohet Lidhja II-5 "Niveli i pagave per punonjesit e ministrive dhe institucioneve te tjera qendrore", te ketij vendimi.